



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 821/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:	Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k., në procedurën e prokurimit publik “ <i>Procedurë e hapur</i> ”, me nr. REF-81835-08-02-2018, me objekt “ <i>Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike</i> ” - <i>Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.</i> ” Loti II “ <i>Blerje bateri per automjete</i> ”, me fond limit 11.207.150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
Ankimues:	“Alked Kopaçi” (Auto Kopaçi) p.f. Rruga e Kavajës, Pll.nr.102, Shk.nr.1, Tiranë
Autoriteti Kontraktor:	Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë
Subjekt i Interesuar:	“Kappa Oil” sh.p.k Lagjja 14, Rruga “Asti Nushi” Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.08.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-81835-08-02-2018, me objekt “Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike” - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.” Loti II “Blerje bateri për automjete”, me fond limit 11.207.150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 03.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.09.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Kappa Oil” sh.p.k.	7.824.000 lekë, kualifikuar
2. “Alked Kopaçi” p.f.	8.280.000 lekë, kualifikuar
3. “Alen-Co” sh.p.k.	8.463.800 lekë, skualifikuar
4. “Ra-Mi Company” sh.p.k.	8.467.200 lekë, kualifikuar
5. “Kadiu” sh.p.k.	9.142.416,67 lekë, kualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. në datën 24.09.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...] Ne kriteret vecanta te kualifikimit eshte parashikuar “Operatori ekonomik qe do te ofertoje per Lotin II “Blerje Bateri” duhet te paraqese katalog te prodhuesit per mallin e ofruar, te vulosur nga operatori ekonomik ku te jete percaktuar lloji i baterise qe ai oferton”. Kemi dyshime te arsyeshme se subjekti nuk ka dorezuar asnje katalog dhe se produktet e deklaruar nuk perputhen me specifikimet teknik te baterive te kerkuar nga ana e autoriteit kontraktor. Kujtojme se ne nenin 27 pika 6/b e VKM 914/2014 parashikon dorezimin e katalogeve ku te verifikohet perpuethshmeria e produkteve te ofertuar me ato te kerkuar. Pra, edhe ne rast se jane paraqitur katalog, keto katalog nuk jane per produktet qe ofertohen dhe nuk permbushin specifikemet teknike. Nënvizojmë se në dokumentat e tenderit, shtojca mbi specifikimet teknike parashikohet:

- 1. Koha e prodhimit të baterive të jetë jo më shumë se 6 muaj nga dita e lëvrimin të mallit nga shitësi;*
- 2. Bateritë duhet të jenë të plotësuara me solucion në rastin kur ato janë hermetike;*
- 3. Bateritë e thata (Në rastin kur kërkohen të tilla nga Autoriteti kontraktor) (që kërkojnë mbushje me solucion) duhet të shoqërohen me sasinë e duhur të solucionit mbushës dhe ujit të distiluar (për plotësim niveli gjatë procesit të punës).*
- 4. Në raste specifike, kur nevojiten bateri me pozicion të poleve (+ ose -) në vend ndodhje të kundërta në bateri, shitësi të marrë përsipër zëvendësimin reciprok të tyre.*

Specifikime teknike Bateri NATO

Lloji Batteri>>

110 NA 125NA

Tensioni nominal

12 V

Kapaciteti Rezervë

200 min.

235 min.

Kapaciteti C20

110 AH

125 AH

Operacioni Temperatura Gama

nga -40 ° C deri në +60 ° C

Shkarkimi actual në:

+25 ° C

-40 ° C

330 A

420s në UF 6V

120S në UF 6V

375 A

420s në UF 6V

120S në UF 6V

Rezerva e përdorshme

30% DoD

30% DoD

raft Jeta

3 muaj

lloji Battery

E mbushur, Lead-Acid

Cikli jetës

235

Jeta

24 muaj

teknologjia

Kalciumi Lead,

Pesha me elektrolit 32,5 kg

34.0 kg

Dimensionet (me 6 të NATO-s)

Pra, bateritë 12V 100AH dhe 12 V 110 AH si edhe bateritë e tjera duhet të plotësojnë specifikimet teknike NATO. Katalogët e dorëzuar nuk përmbushin specifikimet e mësipërme teknike. Gjithashtu kemi dyshime të arsyeshme se oferta teknike nuk përmbush asnjë nga parashikimet në dokumentat e procedurës së prokurimit

-Ne kriteret e vedanta te kualifikimit eshte parashikuar Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Certifikatat vetjake ISO 9001:2008, per tregtimin e mallrave qe jane objekt prokurimi. Ne lidhje me kete pike OE duhe te paraqese, pervec ISO-s se kerkuar, edhe dokument mbeshletes qe verteton se subjekti leshues i ISO-s eshte i akredituar nga institucionet kompetente vendase apo te huaja. Persa kohe qe shoqeria eshte me shume e perqendruar ne objektin e veprimtarise se saj shitjen ne tregun e vaj dhe filtra (lot tjetër procedure prokurimi), kemi dyshime te arsyeshme dhe te bazuara se shoqeria nuk disponon asnje certifikate ISO te leshuar per objekt veprimtarie sipas objektit te prokurimit, te kerkuar ne DST.

-Ne kriteret e vedanta te kualifikimit eshte parashikuar "Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, me objektin e prokurimit, per mallrat e kerkuara. Ne rast se do te paraqitet kjo e fundit, duhet te vertetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te

prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Persa kohe qe shoqeria eshte e perqendruar ne objektin e veprimtarise se saj shitjen ne tregun e vaj dhe filtra (lot tjetere procedure prokurimi), kemi dyshime te arsyeshme dhe te bazuara se shoqeria nuk disponon Autorizim Prodhuesi dhe se autorizimi te permbaje te dhena te sakta te prodhuesit sipas te gjitha kerkesave te DST.

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit me anë të shkresës nr.921/1 datë 25.09.2018, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë.

II.6. Në datën 04.10.2018 operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1204/1 prot., datë 26.11.2018, protokolluar me tonën në datën 27.11.2018, me objekt *“Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike” - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.” Konkretisht Loti II “Blerje bateri per automjete”, me fond limit 11.207.150 lekë (pa TVSH)” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k. me arsyetimin se *“...bateritë 12V 100 AH dhe 12 V 110 AH si edhe bateritë e tjera duhet të plotësojnë specifikimet teknike NATO. Katalogët e dorëzuar nuk përmbushin specifikimet e mësipërme teknike”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, për Lotin II *“Blerje bateri per automjete”, “Kapaciteti teknik”,* pika 7, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog të prodhuesit të baterive (të përkthyer në gjuhën shqipe), ku të evidentohen mallrat dhe specifikimet teknike të baterive (sipas shtojces 10 të DT), të shoqëruar me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:*

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i artikullit (baterisë)</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Emërtimi kompanisë prodhuese</i>	<i>Emërtimi i katalogut</i>	<i>Numri i faqes në katalog</i>	<i>Part-Number i prodhuesit</i>	<i>Standarti i Cilësisë</i>
------------	---	---------------	--------------	-------------------------------------	-----------------------------	---------------------------------	---------------------------------	-----------------------------

Shënim: Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë të gjitha tabelat, si tabelën e përgjithshme edhe tabelat e veçanta me të dhënat e paraqitura (në shtojcën 12) duke patur parasysh nevojat sasiore dhe fondet limit për cdo autoritet kontraktor. Për artikuj të njëjtë, operatorët ekonomik duhet të ofertojë me çmim të njëjtë, në të kundërt oferta e tyre do të konsiderohet e pavlefshme.

III.1.2. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, “Specifikimet teknik”, për Lotin II “Blerje bateri per automjete”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

[...]

- 1. Koha e prodhimit të baterive të jetë jo më shumë se 6 muaj nga dita e lëvrimit të mallit nga shitësi;*
- 2. Bateritë duhet të jenë të plotësuara me solucion në rastin kur ato janë hermetike;*
- 3. Bateritë e thata (Në rastin kur kërkohen të tilla nga Autoriteti kontraktor) (që kërkojnë mbushje me solucion) duhet të shoqërohen me sasinë e duhur të solucionit mbushës dhe ujit të distiluar (për plotësim niveli gjatë procesit të punës).*
- 4. Në raste specifike, kur nevojiten bateri me pozicion të poleve (+ ose -) në vend ndodhje të kundërta në bateri, shitësi të marrë përsipër zëvendësimin reciprok të tyre.*

Specifikime teknike Bateri NATO

Lloji Batteri>>

110 NA 125NA

Tensioni nominal

12 V

Kapaciteti Rezervë

200 min.

235 min.

Kapaciteti C20

110 AH

125 AH

Operacioni Temperatura Gama

nga -40 °C deri në +60 °C

Shkarkimi actual në:

+25 °C

-40 °C

330 A

420s në UF 6V

120S në UF 6V

375 A

420s në UF 6V

120S në UF 6V

Rezerva e përdorshme

30% DoD
 30% DoD
 raft Jeta
 3 muaj
 lloji Battery
 E mbushur, Lead-Acid
 Cikli jetës
 235
 Jeta
 24 muaj
 teknologjia
 Kalciumi Lead,
 Pesha me elektrolit 32,5 kg
 34.0 kg
 Dimensionet (me 6 të NATO-s)
 Garancia për te gjitha llojet e baterive;

1. Bateritë të garantojnë punë të rregullt deri në 12 muaj nga dita e furnizimit.
2. Certifikata e garancisë së baterive të jetë e plotësuar dhe të shoqërojë mallin në momentin e dorëzimit të tij.

III.1.3. Ndërsa në Shtojca 12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, për Lotin II “Blerje bateri per automjete”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

<i>Loti II "Blerje bateri per automjete"</i>					
<i>Nr.</i>	<i>Bateri</i>	<i>Specifikime Teknike te Mallit</i>	<i>Çmimi për njësi/pa TVSH</i>	<i>Sasia totale</i>	<i>Vlera totale pa TVSH</i>
1	12 V 19 AH			4	
2	12 V 30 AH			1	
3	12 V 45 AH			1	
4	12 V 50 AH			1	
5	12 V 55 AH			14	
6	12 V 60 A			61	
7	12 V 65 AH			9	
8	12 V 66 AH			8	
9	12 V 75AH			14	
10	12 V 80 A			55	
11	12 V 85 AH			20	
12	12 V 88 AH			28	
13	12 V 90 AH			4	
14	12 V 100 A			195	
15	12 V 100 AH	(NATO)		110	
16	12 V 100 AH	Pole te kunderta		31	

17	12 V 105 AH			10	
18	12 V 110 AH	(NATO)		22	
19	12 V 120 AH			4	
20	12 V 135 AH			28	
21	12 V 165 AH			100	
22	12 V 180 AH			6	
23	12 V 185 AH			32	
24	12 V 220 AH			13	
<i>Totali pa TVSH</i>					<i>11,207,150</i>

[...]

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka paraqitur:

- *Ofertën teknike të plotësuar sipas tabelës në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit*
- *Katalogun e produkteve*

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 53/3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.7. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të paraqesin katalogët e prodhuesit të baterive (të përkthyer në gjuhën

shqipe), ku të evidentohen mallrat dhe specifikimet teknike të baterive (sipas shtojcës 10 të DT), të shoqëruar me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12). Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k., konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterit e mësipërm ka paraqitur katalogun e prodhuesit të baterive, me të dhënat dhe karakteristikat e produkteve që ky operator ofron. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, se produktet e ofruara nga operatori ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k., konkretisht bateritë 12V 100 AH dhe 12V 110 AH si edhe bateritë e tjera nuk plotësojnë specifikimet teknike NATO, KPP sqaron se, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k., konkretisht katalogët e prodhuesit për produktet që ky operator ofron, konstatohet se në specifikimet teknike të katalogut të prodhuesit që operatori ekonomik “Kappa Oil” ka paraqitur për produktet e ofruara, nuk gjejnë pasqyrim të gjitha specifikimet teknike që autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht në shtojcën 10 të dokumentave të tenderit.

III.1.9. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.11. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alked Kopaçi” p.f., për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k. qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” p.f. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-81835-08-02-2018, me objekt “Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike” - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.” Loti II “Blerje bateri për automjete”, me fond limit 11.207.150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Kappa Oil” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alked Kopaçi” sh.p.k..
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1558 Protokolli

Datë 04.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha